

VENDIM
Nr. 39, datë 10.3.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK PËR RISHIKIMIN E VENDORIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 29, DATË 14.2.2022, “MBI NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË PËRKOHSHËM TË VENDORIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, ‘MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SEKA HYDROPOWER’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘SEKË’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw, DHE ‘ZAIS’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 14962 kw”

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 7, germa “a”, nenit 33, pika 1, germa “b”, nenit 104, pika 1 dhe nenit 180, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 5, pika 23 dhe nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 349/2, datë 7.3.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, ‘Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw””,

konstatoi se:

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 14.2.2022 ka vendosur ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

- Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021, la në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 49, datë 18.1.2021, e cila vendosi shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ, vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, “Për licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw”. Ky vendim u la në fuqi me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021.

- Në vijim të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 14.2.2022, me shkresën nr. 4 prot., datë 28.2.2022, protokolluar në ERE me nr. 326 prot., datë 28.2.2022, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., ka kërkuar rishikimin dhe pezullimin e këtij vendimi, në përputhje të sa përcaktuar në nenin 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016 dhe ka përcjellë argumentet, si vijon:

- HEC “Zais” nuk ndodhet brenda zonave të mbrojtura, sipas hartave të publikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 59, datë 26.1.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, duke e cilësuar këtë një provë që do të shërbejë dhe në procesin dhe kërkesat e paraqitura nga ajo pranë Gjykatës së Lartë.

- Vendimmarrja e Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, do t’i shkaktonte asaj një dëm ekonomik të konsiderueshëm.

- Në kuptim të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 33, pika 1, germa “b”, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96/2016, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., konsiderohet palë në proces, pasi vendimi i Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022, për të cilën është kërkuar rishikimi dhe pezullimi, i drejtohet kësaj shoqërie.

- Pikat 3 dhe 4, të nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, i njohin të drejtën e Bordit të ERE për të pezulluar aktin e miratuar nga vetë ai, sipas një kërkesë të paraqitur nga një subjekt i interesuar, në përputhje me rrethanat specifike.

- Për sa i përket afatit 7-ditor të paraqitjes së kërkesës për rishikim, që përbën dhe kushtin e dytë që duhet plotësuar, vlerësohet gjithashtu se përmbushet, pasi shoqëria ka referuar në shkresën e saj që ka marrë dijeni përmes faqes së web-it të ERE (më datë 15.2.2022 është publikuar njoftimi mbi vendimet e mbledhjes së datës 14.2.2022, ndërsa më datë 28.2.2022 është publikuar vendimi nr. 29, datë 14.2.2022), ndaj dhe përlllogaritja e afateve fillon me marrjen dijeni nga subjekti, në zbatim të sa përcaktuar në nenin 104, pika 1 të “Kodit të Procedurave Administrative”.

- Lidhur me provat e reja, si kusht thelbësor për rishikimin e një vendimi të ERE-s, sqarojmë se:

- VKM nr. 59, datë 26.1.2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, e paraqitur si një provë e re në kuptim të ligjit nr. 43/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96/2016, ka rëndësi për çështjen për të cilën është marrë vendimi i Bordit të ERE-s nr. 29/2022, si dhe në të njëjtën kohë krijon rrethana specifike të cilat kërkojnë shqyrtimin e sa paraqitur nga pala në cilësinë e provës, duke përfshirë këtu dhe korrespondencën me institucionet/organet kompetente për përcaktimin e zonës dhe hapësirës, statusi i së cilës ka ndryshuar.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e palës së interesuar duhet të bëjë analizimin e përmbajtjes së hartave dhe tabelave të koordinatave të ndryshuara në shtojcat që i bashkëlidhen VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022 dhe të depozitojë në ERE aktin përkatës të ekspertimit ose çdo dokument tjetër të hartuar nga persona të licencuar të fushës, ku të vërtetohet se bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, HEC “Zais” ndodhet jashtë zonave të mbrojtura.

- Duke qenë se shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. legjitimohet si palë në këtë proces dhe ka paraqitur kërkesën brenda afateve ligjore të parashikuara, vlerësohet të pranohet shqyrtimi i kërkesës së saj për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29/2022.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion përkatës vërtetues mbi sa paraqitur nga ajo si provë e re, brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja dijeni e këtij vendimi. Në vijim ERE do të shqyrtojë dokumentacionin e depozituar nga shoqëria dhe do të marrë vendimin përkatës brenda 10 ditëve kalendarike nga paraqitja e këtij dokumentacioni.

- Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, është paraqitur Rekurs pranë Gjykatës së Lartë, dhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatave, konkretisht vendimit nr. 49/2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe vendimit nr. 559/221, të Gjykatës Administrative të Apelit, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Lartë dhe pezullimi mban datën 25.2.2022.

- Për sa më sipër vendosur nga Gjykata e Lartë dhe për sa kërkuar nga subjekti, që mbështetet dhe në dispozitat e rregullores që i njeh ERE-s kompetencën për të pezulluar zbatimin e një akti administrativ të nxjerrë prej saj, vlerësojmë që të pezullohet zbatimi i vendimit të Bordit të ERE-s

nr. 29/2022, deri sa të sqarohen rrethanat e VKM-së nr. 59/2022 dhe Gjykata e Lartë të shprehet mbi rekursin e paraqitur.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022 “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

2. Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., në cilësinë e palës së interesuar, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE aktin përkatës të ekspertimit ose çdo dokument tjetër të hartuar nga persona të licencuar të fushës, ku të vërtetohet se bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 59, datë 26.1.2022, HEC “Zais” ndodhet jashtë zonave të mbrojtura.

3. ERE do të shqyrtojë dokumentacionin e depozituar nga shoqëria sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi brenda 10 ditëve pas paraqitjes së këtij dokumentacioni.

4. Pezullimin e zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.2.2022 “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Sekë’, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe ‘Zais’, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”, sipas vendimit datë 25.2.2022, të Gjykatës së Lartë.

5. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti